



KODI I PRAKTIKËS SË SHKËMBIMIT TË TË DHËNAVE PERSONALE

Përmbajtja e Kodit Praktik

KREU I – FJALA E KOMISIONERES	3
KREU II- RRETH KODIT	4
Statusi i Kodit	4
Kush duhet ta përdor këtë kod praktike?	4
Si mund të ndihmoj kodi?	4
Çfarë përfitojnë kontrolluesit e të dhënave nga ky kod?	4
Kreu III- Çfarë nënkuptojmë me “shkëmbim të të dhënave”	6
Shkëmbimi i të dhënave në mënyrë të përkohshme	6
Shkëmbim me “përpunues të të dhënave”	6
Kreu IV- Të vendosësh të shkëmbesh të dhëna personale	8
Faktorët për tu marrë në konsideratë	8
Kreu V- Kushtet për përpunim	10
Kreu VI- Autoritetet	12
Përgjegjësia	12
Marrëveshjet për shkëmbimin e të dhënave	12
Të vlerësosh ndikimin ndaj privatësisë	13
Standartet e të dhënave	13
Kreu VII- Siguria	19
Kreu IIX- Marrëveshjet për shkëmbimin e të dhënave	22
Aneks 1- Përkufizimet	25
Aneks 2- Modeli i formës së kërkesës për shkëmbimin të të dhënave	27
Aneks 3- Model i formës së vendimit për shkëmbimin e të dhënave	28

Fjala e Komisioneres për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Të nderuar lexues,

Më lejoni të prezantoj pranë Jush kodin e praktikës së shkëmbimit të të dhënave personale. Ky kod shpjegon se si Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar, aplikohet për shkëmbimin e të dhënave personale. Kodi ka për qëllim t'ju ofrojë kontrolluesve që veprojnë në Republikën e Shqipërisë praktika sa më të qarta dhe të kuptueshme mbi shkëmbimin e të dhënave dhe që do të ndihmojnë ata të respektojnë ligjin dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave personale.

Kodi i praktikës që prezantojmë është i hartuar me dispozita të qarta, dhe parashikon këshilla të mira që do të jenë të rëndësishme për të gjithë kontrolluesit që shkëmbejnë të dhëna personale.

Hartimi i këtij Kodi, është parë si i nevojshëm pasi në ditët tona shkëmbimi dhe përhapja e të dhënave personale është një procedurë rutinë ndërmjet kontrolluesve. Përpara se të ndërmarrin një veprim të tillë, kontrolluesit duhet të evidentojnë qartë qëllimin për të cilin po bëjnë shkëmbimin ose objektivin që dua të arrijnë me shkëmbimin e të dhënave. Shkëmbimi duhet bërë duke siguruar masat e duhura të sigurisë, duke specifikuar qartë personat përgjegjës tek kontrolluesi që do të kenë akses në këto të dhëna, ndërkohë që dhe punonjësit e kontrolluesit duhet të njihen me parimin konfidencialitetit.

Për të pasur një shkëmbim të suksesshëm dhe të ligjshëm të të dhënave personale, është e nevojshme që kontrolluesit, para së gjithash, të arrijnë të bëjnë balancimin e asaj që duhet të shkëmbehet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe asaj që nuk mund të shkëmbehet në bazë të natyrës së informacionit. Kontrolluesit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre duhet të përmbushin disa detyrime në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Këto detyrime do të jenë të zbatueshme si për kontrolluesin publik dhe atë privat.

Hartimi i Kodit është bërë në përputhje me praktikën më të mirë vendase dhe ndërkombëtare dhe si rezultat i shume diskutime me ekspertë ndërkombëtarë që kanë asistuar zyrën e Komisionerit gjatë këtyre pesë viteve të ushtrimit të aktivitetit të tij.

Së fundmi, jeni të lutur të vizitoni faqen e internetit të Komisionerit (www.idp.al) për të marrë informacione të mëtejshme dhe të detajuara rreth mbrojtjes së të dhënave tuaja personale.

Ju faleminderit,

KOMISIONERI

Flora ÇABEJ (POGAÇE)

Rreth Kodit

Statusi i Kodit.

Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale ka përgatitur dhe publikuar këtë kod në zbatim të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 30 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Kodi shpjegon se si Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar, aplikohet për shkëmbimin e të dhënave personale. Ai gjithashtu parashikon këshilla të mira që do të jenë të rëndësishme për të gjithë kontrolluesit që shkëmbejnë të dhëna personale. Ky kod mund të përdoret si për punonjësit e Komisionerit po ashtu edhe për kontrollues publik dhe privat.

Kush duhet ta përdorë këtë kod praktike?

Çdo kontrollues të dhënash që gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij është i përfshirë në shkëmbimin e të dhënave personale duhet të përdorë këtë kod. Ky kod do të ndihmojë kontrolluesit se si të adoptojnë praktikën e shkëmbimit dhe është i zbatueshëm si për kontrolluesin publik dhe ata privat por dhe do të ndihmojë subjektin e të dhënave për njohjen e procedurës që ndiqet gjatë shkëmbimit.

Si mund të ndihmojë kodi?

Përshtatja/adoptimi i rekomandimeve të parashikuara në këtë kod do t’ju ndihmojnë ju të mblidhni dhe të shkëmbeni të dhëna në mënyrë të drejtë, transparente dhe në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e subjekteve, informacionet e të cilëve jeni duke shkëmbyer.

Kodi do ju ndihmojë për të identifikuar çështjet që ju duhet të merrni në konsideratë kur të vendosni nëse do të shkëmbeni të dhëna personale.

Çfarë përfitojnë kontrolluesit e të dhënave nga ky kod?

- minimizimin e riskut për shkeljen e ligjit dhe zbatimin e ligjit nga kontrolluesit e tjerë;
- besimin në publik duke garantuar që masat ligjore të kërkuara janë në fuqi dhe në përputhje me kodin;
- mbrojtjen e mirë për subjektet kur të dhënat e tyre janë duke u shkëmbyer;
- rritjen e shkëmbimit të të dhënave kur është e nevojshme dhe e dobishme;

- më shumë besim dhe një marrëdhënie më të mirë me subjektet të cilëve u shkëmbehen informacione që ju dëshironi;
- reduktime të rrezikut shkaktuar nga shkëmbimi i papërshtatshëm i të dhënave personale;
- një mirëkuptim të mirë në rastet kur/ apo nëse pranohet të shkëmbejnë informata pa dijeninë apo pëlqimin e subjekteve, dhe
- reduktime të rrezikut të pyetjeve, ankesave dhe mosmarrëveshjeve për mënyrën se si ju shkëmbeni të dhënat personale.

Çfarë nënkuptojmë me “shkëmbim të të dhënave”

Me “shkëmbim të të dhënave¹” do të kuptojmë përhapjen/zbulimin e të dhënave për një ose më shumë kontrollues, për një palë të tretë, si dhe shkëmbimin e të dhënave ndërmjet strukturave të ndryshme brenda të një kontrolluesi. Të dhënat që shkëmbehen mund të jenë:

- reciproke ose në mënyra reciproke;
- informacione të mbledhura nga disa kontrollues dhe të vendosura në dispozicion të një pale të tretë.
- informacione të mbledhura nga një kontrollues, të cilat vendosen në dispozicion të strukturave të vetë kontrolluesit;

Ka raste kur në shkëmbimin e të dhënave nuk përfshihen të dhënat personale, për shembull kur shkëmbehen vetëm të dhëna statistikore dhe nuk arrihet të bëhet identifikimi i individit.

Kodi mbulon dy lloje të shkëmbimit të të dhënave:

- sistematike; shkëmbimi rutinë i të dhënave kur të dhëna të përcaktuara janë shpërndarë ndërmjet të njëjtit kontrollues për një qëllim të caktuar; dhe
- të veçantë; kur për një vendim mblidhet informacion i gjerë brenda strukturës së kontrolluesit dhe shkëmbehet tek një kontrollues tjetër.

Shkëmbimi i të dhënave në mënyrë të përkohshme

Shkëmbimi i të dhënave shumë herë zhvillohet në një mënyrë të para-planifikuar dhe rutinë. Si i tillë, vendosen rregulla dhe procedura të përcaktuara. Megjithatë, kontrolluesit mund të vendosin, ose të pyeten, për të shkëmbyer të dhëna në situata të cilat nuk janë të mbuluara nga një marrëveshje rutinë.

Në disa raste kjo mund të përfshijë një vendim në lidhje me shkëmbimin duke e bërë në kushtet e një nevoje ekstreme, për shembull në një situatë emergjente.

Shkëmbim me “përpunues të të dhënave”

Kodi i praktikës është i lidhur kryesisht me shkëmbimin e të dhënave personale mes kontrolluesve të të dhënave - domethënë kur dy kontrollues përcaktojnë qëllimin për të cilat të dhënat personale do të përpunohen.

¹ Në përmbajtje të këtij kodi, termi “shkëmbim të të dhënave” do të përfshijë dhe “përhapjen e të dhënave” në varësi të kontekstit të fjalisë.

Megjithatë, ekziston një formë e shkëmbimit të të dhënave, në rastet kur një kontrollues ndan të dhënat me një palë tjetër që përpunon të dhënat personale në emër të tij. Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale këto autoritete i njeh si përpunues të të dhënave.

Ligji për mbrojtjen e të dhënave kërkon që kontrolluesi i të dhënave kur ngarkon një përpunues për përpunimin e të dhënave duhet ta bëjë këtë me një kontratë me shkrim, ku në të të specifikohet se, përpunuesi duhet:

- të përpunojë të dhënat vetëm në përputhje me udhëzimet e kontrolluesit; të mos i transmetojë ato, përveç kur ka marrë udhëzim nga kontrolluesi;
- të marrë të gjitha masat e sigurisë, sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të punësojë operatorë, të cilët kanë detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë;
- të krijojë, në marrëveshje me kontrolluesin, kushtet e nevojshme teknike dhe organizative për përmbushjen e detyrimeve të kontrolluesit, për të siguruar të drejtat e subjekteve të të dhënave personale;
- t'i dorëzojë kontrolluesit, pas përfundimit të shërbimit të përpunimit, të gjitha rezultatet e përpunimit dhe dokumentacionit, që përmban të dhëna ose t'i mbajë apo t'i shkatërrojë ato me kërkesë të kontrolluesit;
- të vërë në dispozicion të kontrolluesit të gjithë informacionin e nevojshëm, për të kontrolluar përputhshmërinë me detyrimet, që rrjedhin sipas shkronjave të mësipërme.

Të vendosësh të shkëmbesh të dhënat personale

Faktorët për t'u marrë në konsideratë

Kur të vendoset nëse do të nënshkruhet një marrëveshje për të shkëmbyer të dhënat personale (në rolin e ofruesit, pranuesit ose në të dy rastet) ju duhet të identifikoni objektivin që marrëveshja ka për qëllim të arrijë. Duhet të merrni në konsideratë të mirat dhe rreziqet e mundshme, qoftë të subjekteve apo edhe të kontrolluesve. Ju gjithashtu, duhet të vlerësoni pasojat e mundshme që mund të vijnë po të mos shkëmbehen të dhënat.

Ju duhet të pyesni veten:

- **Çfarë ka për qëllim të arrijë shkëmbimi?** Ju duhet të keni një objektiv ose një grup objektivash të qartë. Duke qenë të qartë në lidhje me këtë, do të keni mundësi të përcaktoni se çfarë të dhënash ju duhet të shkëmbeni dhe me kë. Mirë do të ishte dokumentimi i kësaj praktike.
- **Çfarë informacioni duhet të shkëmbehet?** Ju nuk duhet të shkëmbeni të gjitha të dhënat personale që ju keni në lidhje me dikë në qoftë se vetëm disa lloje të dhënash janë të nevojshme për të arritur objektivat tuaja. Për shembull, ju mund të keni nevojë për të shkëmbyer emrin aktual dhe adresën e dikujt, por asnjë informacion tjetër që ju keni rreth tij.
- **Kush kërkon akses në të dhënat personale që do të shkëmbehen?** Ju duhet të përdorni parimin 'vetëm çka duhet të dini', që do të thotë se kontrolluesit e tjerë duhet të kenë akses në të dhënat tuaja vetëm nëse ata kanë nevojë për to, dhe vetëm personeli përkatës brenda këtyre institucioneve duhet të ketë akses në të dhënat. Kjo duhet të trajtojë çdo kufizim të nevojshëm mbi shkëmbimin e mëtejshëm të të dhënave me palët e treta.
- **Kur duhet bërë shkëmbimi?** Përsëri, kjo është një praktikë për t'u dokumentuar. Për shembull, duke përcaktuar nëse shkëmbimi duhet të jetë i vazhdueshëm, si një proces rutinë apo nëse duhet të ndodhë vetëm si përgjigje ndaj rasteve të veçanta.
- **Si duhet të jetë shkëmbimi?** Kjo përfshin trajtimin e sigurisë për sa i përket transmetimit ose aksesit ndaj të dhënave dhe vendosjen e rregullave të përbashkëta për sigurinë e tij.
- **Si mund të kontrolloni nëse shkëmbimi po arrin objektivat e tij?** Do t'ju duhet të gjykoni nëse shkëmbimi është ende i përshtatshëm dhe të konfirmoni që ruajtja e të dhënave tej kohës së përcaktuar justifikon akoma rreziqet.

- **Çfarë rreziqesh paraqet shkëmbimi i të dhënave?** Për shembull, a ka të ngjarë që ndonjë subjekt të jetë dëmtuar nga shkëmbimi? A ka të ngjarë që ndonjë subjekt të kundërshtojë atë? A mund ta lëkundë ajo besimin e subjekteve në institucione që ruajnë të dhëna rreth tyre?
- **A mund të arrihet objektivi pa shkëmbimin e të dhënave apo duke e bërë atë në mënyrë anonime?** Nuk është e përshtatshme të përdoren të dhënat personale për të planifikuar ofrimin e shërbimit, për shembull, kur kjo mund të bëhet me informacion që nuk arrin deri te të dhënat personale.
- **A duhet të bëni sërish regjistrimin pranë Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale?** Ju duhet të siguroheni që procesin e shkëmbimit (përhapjes) ta keni deklaruar në formularin e njoftimit kur keni njoftuar për herë të parë. Nëse jo, ju duhet të përditësoni njoftimin e bërë.
- **A do të transferohet ndonjë prej të dhënave të shkëmbyera jashtë vendeve të përcaktuara në Vendimin nr.3, datë 20.11.2012 “Për përcaktimin e shteteve, me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”?** Nëse është kështu, ju duhet të merrni parasysh kërkesat e parashikuara në nenet 8 dhe 9 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si dhe Vendimin nr. 3, datë 20.11.2012 “Për përcaktimin e shteteve, me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”. Për udhëzime më të hollësishme konsultohuni me faqen zyrtare të Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale: www.idp.al

Kushtet për përpunim

Parimi i përgjithshëm i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale është se përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private.

Parimet për mbrojtjen e të dhënave shprehen se institucionet duhet të plotësojnë një ose më shumë 'kushte' në mënyrë që të legjitimojnë përpunimin e të dhënave personale, përveçse kur ka ndonjë përjashtim. Është e rëndësishme që të jetë e qartë se përmbushja e një kushti për përpunimin, në vetvete nuk do të sigurojë që shkëmbimi i të dhënave personale është i drejtë apo i ligjshëm. Këto çështje duhet të shqyrtohen në veçanti. Pëlqimi (pëlqim i shprehur qartë me shkrim) është një nga kushtet që ligji për mbrojtjen e të dhënave ofron për të legjitimuar përpunimin. Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave përcakton përkufizimin e pëlqimit si:

“Pëlqim i subjekteve të të dhënave” është çdo deklaratë me shkrim, e dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij.”

Duhet pra të jetë një formë e komunikimit aktiv ku individi me vetëdije tregon pëlqimin. Ndërsa pëlqimi do të sigurojë një bazë mbi të cilat institucionet mund të shkëmbejnë të dhënat personale, megjithatë KMDP pranon se kjo nuk është gjithmonë e arritshme. Nëse do të mbështeteni në pëlqimin si kushtin tuaj, duhet të jeni të sigurt se subjektet e dinë saktësisht se për çfarë të dhënash japin pëlqimin dhe të kuptojnë ndërlikimet e dhënies së tij për ta. Ata duhet gjithashtu të kenë kontroll të mirëfilltë nëse bëhet apo jo shkëmbimi i të dhënave.

Pëlqimi për shkëmbimin e të dhënave është i nevojshëm kur:

- informacioni konfidencial ose sensitiv do të shkëmbehet pa një bazë të qartë ligjore; për ta bërë këtë:

- ✓ ka gjasa që individi mund të ketë kundërshtuar më parë shkëmbimin e të dhënave pa pëlqimin e tij ose të saj,

ose

- ✓ shkëmbimi ka gjasa të ketë një ndikim të rëndësishëm mbi një individ ose grup i individësh.

Kushtet e tjera që ofrojnë një bazë për përpunimin e më tej shkëmbimin e të dhënave personale jo sensitive përfshijnë:

- nëse përpunimi është thelbësor për përmbushjen e një kontrate, për të cilën subjekti i të dhënave është palë kontraktuese, apo për diskutime ose ndryshime të një projekti/kontrate me propozimin e subjektit të të dhënave;
- për të mbrojtur interesat jetikë të subjektit të të dhënave;
- për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit;
- për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetence të kontrolluesit ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat;
- nëse është thelbësor për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitime të kontrolluesit, marrësit apo personave të tjerë të interesuar. Por, në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale nuk mund të jetë në kundërshtim të hapur me të drejtën e subjektit të të dhënave për mbrojtjen e jetës personale dhe private.
- Përpunimi i të dhënave personale, të përcaktuara në kuadër të veprimtarive të parandalimit dhe ndjekjes penale, për kryerjen e një vepre penale kundër rendit publik dhe të veprave të tjera në fushën e të drejtës penale, si dhe në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, kryhet nga autoritetet zyrtare të përcaktuara në ligj.
- Kontrolluesi apo përpunuesi, që merret me përpunimin e të dhënave personale, me qëllim ofrimin e mundësive për biznes apo të shërbimeve, mund të përdorë për këtë qëllim të dhëna personale të marra nga lista publike të dhënash.

Kontrolluesi apo përpunuesi nuk mund të vazhdojë përpunimin më tej të të dhënave të specifikuar me lartë, nëse subjekti i të dhënave ka shprehur mospajtim ose ka kundërshtuar përpunimin e mëtejshëm të tyre. Asnjë e dhënë personale shtesë nuk mund t'i bashkëlidhet të dhënave të specifikuar më lart, pa pëlqimin e subjektit të të dhënave.

Sa më lartë, është nënvizuar se përpunimi duhet të jetë në përputhje me "interesat legjitime". Kushti i 'interesave legjitime' ofron baza për përpunimin e të dhënave personale në një situatë ku një institucion ka nevojë për ta bërë këtë për qëllimet dhe interesat e veta legjitime apo interesat legjitime të palës së tretë së cilës i është bërë i ditur informacioni. Ky kusht nuk mund të plotësohet nëse përpunimi është i pajustificuar sepse paragjykon të drejtat dhe liritë apo interesat legjitime të subjektit të dhënave të cilit i përpunohen këto të dhëna. Ky kusht nuk mund të legjitimojë përpunimin e të dhënave sensitive.

Përgjegjësia

Institucione të ndryshme të përfshira në një nismë shkëmbimesh të të dhënave do të kenë secila përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre, në lidhje me të dhënat që ata japin/bëjnë me dije ose kanë marrë. Çështjet që kanë për qëllim të adresojnë shkëmbimin e të dhënave mund të jenë shumë të ndjeshme, dhe vendimet që mund të marrin anëtarët e stafit mund të kenë nevojë për përvojë të madhe dhe për gjykim të shëndoshë. Prandaj është praktikë e mirë për një zyrtar të lartë, një person me përvojë në secilin nga institucionet e përfshira në shkëmbim që të marrë përgjegjësi të plotë për një mbarëvajtje të informacionit, duke siguruar pajtueshmëri me ligjin, si dhe dhënien e këshillave për stafin që ballafaqohet me marrjen e vendimeve në lidhje me shkëmbimin e të dhënave.

Marrëveshjet për shkëmbimin e të dhënave

“Marrëveshjet për shkëmbimin e të dhënave” të njohura ndonjëherë në praktikën ndërkombëtare si “protokollet për shkëmbimin e të dhënave” përcaktojnë një grup rregullash të përbashkëta për t’u miratuar nga institucione të ndryshme të përfshira në një proces shkëmbimesh të dhënash. Këto mund të formojnë pjesë të një kontrate mes institucioneve. Është praktikë e mirë që të ketë një marrëveshje për shkëmbimin e të dhënave në vend, si dhe për ta rishqyrtuar atë rregullisht, sidomos kur informacioni që shkëmbehet është i një sasive të madhe.

Një marrëveshje për shkëmbimin e të dhënave duhet, të paktën, të dokumentojë çështjet e mëposhtme:

- qëllimin, ose qëllimet e shkëmbimit;
- përfituesin potencial apo tipet e përfituesve dhe rrethanat në të cilat ata do të kenë akses;
- të dhënat që do tu shkëmbehen;
- cilësinë e të dhënave – saktësia, përdorimi, etj;
- sigurinë që do tu mundësohet të dhënave të shkëmbyera;
- ruajtjen e të dhënave të shkëmbyera;
- të drejtat e subjekteve - procedurat për trajtimin e kërkesave, pyetjeve dhe ankesave;

- rishikimin e përfundimit të marrëveshjes së shkëmbimit;

dhe

- sanksione për mosrespektimin e marrëveshjes apo shkeljet nga individët e stafit.

Kreu VIII i këtij kodi përcakton elementet kryesorë të një marrëveshjeje për shkëmbimin e të dhënave

Të vlerësosh ndikimin ndaj privatësisë

Është mirë që të kryhet një vlerësim i ndikimit në privatësi para se të nënshkruajmë ndonjë marrëveshje për shkëmbimin e të dhënave. Kjo do t'ju ndihmojë që të vlerësoni përfitimet që mund të sjellë shkëmbimi i të dhënave ndaj subjekteve të veçantë apo më gjerë në kompani. Kjo do t'ju ndihmojë gjithashtu të vlerësoni rreziqet ose efektet e mundshme negative, të tilla si një rënie të ruajtjes së privatësisë personale, ose mundësinë e dëmit ose shqetësimin që mund t'ju shkaktohet individëve. Ju duhet të merrni parasysh si dëmin që u shkaktohet subjekteve, ashtu edhe dëmin potencial për reputacionin e institucionit tuaj të cilat mund të lindin nëse shkëmbimi i të dhënave bëhet në mënyrë të papërshtatshme, ose kur ato nuk shkëmbehen brenda afatit kur duhet të bëhet ky shkëmbim.

Standardet e të dhënave

Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale ka për objekt përcaktimin e rregullave për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale. Këto rregulla duhet të përdoren edhe gjatë shkëmbimit të të dhënave. Është e rëndësishme të ketë procedura për të ruajtur cilësinë e të dhënave personale që ju mbani, sidomos kur keni ndërmend t'i shkëmbeheni ato. Kur planifikoni të shkëmbeheni të dhëna me një kontrollues tjetër, ju duhet të merrni parasysh të gjitha pasojat mbi cilësinë e tyre.

Kur shkëmbeheni informacion, ju duhet të merrni parasysh çështjet e mëposhtme:

- **Sigurohuni që formati i të dhënave që ju shkëmbeheni është i përputhshëm me sistemet e përdorura nga të dy institucionet.**

Disa institucione mund të përdorin sisteme IT shumë të ndryshme, me hardware dhe software të ndryshëm dhe procedura të ndryshme për përdorimin e tij. Kjo do të thotë se mund të jetë shumë e vështirë për të 'bashkuar' sistemet së bashku në mënyrë që të dhënat personale të shkëmbehen siç duhet. Duhet t'i jepet rëndësia e duhur këtyre çështjeve teknike kur të vendoset nëse, apo si, shkëmbehen të dhënat personale.

Gjithashtu institucionet mund të regjistrojnë të njëjtin informacion në mënyra të ndryshme. Për shembull, data e lindjes së një personi mund të regjistrohet në formate të ndryshme. Kjo mund të çojë që të dhënat të mos korrespondojnë apo të prishen. Nëse mbahet një regjistrim jo i plotë ekziston rreziku që kjo t'u shkaktojë dëme individëve, që do të thotë që ju nuk ofroni shërbime në mënyrë korrekte. Para shkëmbimit të informacionit ju duhet të siguroheni që institucionet e përfshira kanë një mënyrë të përbashkët të regjistrimit të informacionit kryesor, për shembull duke vendosur një format standard për regjistrimin e emrave të subjekteve. Një problem relativisht i zakonshëm këtu është regjistrimi i emrave të cilat përmbajnë gërma jo-latine. Çdo institucion mund të ketë mënyrën e vet të regjistrimit të tyre, në varësi të kapaciteteve të sistemit të tij. Nëse ju nuk mund të krijoni një standard të përbashkët për regjistrimin e informacionit, ju duhet të përpunoni një mjet të besueshëm për shndërrimin e informacionit.

Nëse karakteret në një grup të dhënash janë koduar duke përdorur një sistem të ndryshëm, ata nuk mund të transferohen në mënyrë të saktë. Ju duhet të siguroni që të dhënat që do të shkëmbehen janë në përputhje me të dy sistemet, veçanërisht në rastet ku ka gjasa të përdoren gërma jo standarde.

Duke pasur parasysh problemet e ndërveprimit që mund të lindin, është praktikë e mirë për institucionet që mund të përfshihen në shkëmbimin e të dhënave që të kërkojnë standarde të njëjta të dhënash.

• Kontrolloni që informacioni që ju shkëmbeni është i saktë para se ta shkëmbeni atë me të tjerët.

Para se ju të shkëmbeni të dhënat, duhet të merrni masa për të kontrolluar saktësinë e tyre. Pasi informacioni të shkëmbehet, mund të jetë i vështirë ndryshimi i tij, kështu që ju duhet të bëni kontrollin e tij përpara se të shkëmbehet. Masat që ju duhet të merrni varen nga natyra e të dhënave të përfshira. Nëse ju shkëmbeni të dhëna sensitive dhe çdo pasaktësi mund të dëmtojë subjektin e të dhënave, do t'ju duhet kujdes më i lartë për t'u siguruar që informacioni është i saktë.

Është praktikë e mirë për të kontrolluar herë pas here nëse informacioni i shkëmbyer është i cilësisë së mirë. Për shembull, mund të shqyrtoni një mostër nga të dhënat për t'u siguruar që informacioni i përfshirë në to ruhet i përditësuar. Sa më e madhe shkalla e shkëmbimit të të dhënave, aq më rigoroz duhet të jetë përdorimi i mostrave. Është ide e mirë t'u tregohen të dhënat që që i përkasin subjekteve në mënyrë që të mund të kontrollohet cilësia e të dhënave që disponohet për ta.

• Krijimi i mënyrave për të bërë të sigurt që të dhënat e pasakta të korrigjohen nga të gjithë kontrolluesit që i kanë ato.

Ju duhet të siguroheni që janë përcaktuar procedura për ndryshimin e të dhënave pasi ato janë shkëmbyer. Kjo mund të ndodhë për shkak se subjekti i të dhënave ju njofton për një pasaktësi,

ose për shkak se ju kanë kërkuar që të përditësoni detajet e tyre. Veprimi që duhet të merrni do të varet nga rrethanat e secilit rast. Nëse është menduar që të dhënat të përdoren në vazhdimësi atëherë mund të jetë e nevojshme që të gjithë kontrolluesit që i kanë, të mund t'i ndryshojnë ato. Nëse shumë kontrollues shkëmbejnë informacion në një partneritet, ato duhet të vendosin se kush është përgjegjës për mirëmbajtjen e saktësisë së të dhënave dhe i cili duhet ti përgjigjet ndonjë ankese ose kërkesë për ndryshim të dërguar nga subjekti i të dhënave por edhe ndonjë ankesë që mund të paraqitet nga një prej kontrolluesve brenda partneritetit.

• Marrëveshje mbi periudhën e përbashkët të ruajtjes dhe marrëveshje mbi asgjësimin e të dhënave që merrni dhe dërgoni.

Kontrollues të ndryshëm që shkëmbejnë të dhëna personale duhet të kenë një marrëveshje në lidhje me çfarë duhet të ndodhë kur përmushet nevoja për përpunimin e të dhënave. Nëse informacioni është ruajtur në mënyrë elektronike, ai duhet të fshihet, dhe duhet të dërgohet një njoftim zyrtar për fshirjen. Nëse është zgjidhur çështja e veçantë që kishte për qëllim shkëmbimin e të dhënave, të gjitha institucionet e përfshira duhet të fshijnë kopjet e tyre të informacionit, përveçse kur ka një kërkesë për t'i mbajtur ato për ndonjë qëllim tjetër, për shembull arkivim. Të dhënat në letër mund të shkaktojnë probleme të veçanta. Mund të jetë e lehtë të anashkalohet prania e të dhënave të vjetra në letër në arkiva apo sisteme dokumentimi por ato mund të përmbajnë të dhëna personale që i nënshtrohen ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Pasi ka kaluar nevoja për t'i ruajtur ato, të dhënat në letër duhet të asgjësohen ose t'i kthehen institucionit nga kanë ardhur.

Kontrollues të ndryshëm të përfshirë në një nismë të shkëmbimit të të dhënave mund të kenë nevojë të vendosin periudhat kohore të tyre të ruajtjes së informacionit, ndoshta sepse ata punojnë me periudha të ndryshme ruajtjeje të parashikuara në ligj. Megjithatë, në qoftë se të dhënat e shkëmbyera nuk janë më të nevojshme për qëllimin për të cilin ishin shkëmbyer, atëherë të gjitha institucionet me të cilat janë shkëmbyer duhet t'i asgjësojnë ato. Sidoqoftë, kontrolluesi, apo kontrolluesit, që mbledhin të dhënat në radhë të parë mund të jenë në gjendje, ose t'i kërkojnë, që t'i ruajnë të dhënat origjinale për një qëllim tjetër legjitim.

Disa informacione do të jenë subjekt i një periudhe ruajtjeje të njohur me ligj (si në rastin e afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 9154, datë 06.01.2003 "Për arkivat") dhe kjo duhet të pasqyrohet. Ju duhet të jeni të sigurt që çdo institucion që ka një kopje të informacionit e asgjëson edhe atë në përputhje me ligjin.

Nëse ju mund të hiqni të gjitha informacionet identifikuese nga një grup të dhënash në mënyrë që ato të mos përmbajnë më të dhëna personale, atëherë ato mund të ruhen për një kohë të pacaktuar.

• Trajnimi i stafit tuaj në mënyrë që ata të dinë se kush ka autoritet për të shkëmbyer të dhënat personale, si dhe në çfarë rrethanash mund të ndodhë kjo.

Është e domosdoshme të sigurohet trajnim i personelit mbi shkëmbimin e të dhënave për personelin që mund të marrë vendime të rëndësishme në lidhje me shkëmbimin e të dhënave ose të kenë akses në të dhënat e përbashkëta. Natyra e trajnimit do të varet mbi rolin e tyre përse i përket shkëmbimit të të dhënave personale. Personeli mund të përfshihet në ndonjë trajnim që tashmë ju është dhënë nga Autoriteti i Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale për mbrojtjen e të dhënave, për sigurinë, ose mbi detyrimet ligjore të personelit.

Në varësi të rolit që ka stafi në kompani do të jetë i nevojshëm dhe kategorizimi i tyre për trajnim. Ata ndahen në persona që:

- planifikojnë dhe marrin vendime në lidhje me shkëmbimin sistematik;
- administrojnë sisteme; ose
- marrin vendime në një situatë

Trajnimi duhet t'i ofrojë stafit mundësinë e përgatitjes së vendimeve në lidhje me shkëmbimin e të dhënave, si dhe të trajnohen lidhur me të dhënat që ata mbajnë.

Njerëzit të cilët kanë përgjegjësinë e plotë për shkëmbimin e të dhënave duhet të kuptojnë:

- ligjet përkatëse që mundësojnë shkëmbimin e të dhënave, duke përfshirë dhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale;
- çdo udhëzim përkatës profesional ose rregulla mbi etikën;
- marrëveshjet për shkëmbimin e të dhënave dhe nevojën për t'i rishqyrtuar ato;
- si punojnë së bashku sisteme të ndryshme informative;
- sigurinë dhe hyrjen e autorizuar në sisteme që ruajnë të dhëna të përbashkëta;
- si të kryhen kontrole me cilësi në të dhëna; dhe
- periudhat e ruajtjes së të dhënave të shkëmbyera.

Ata gjithashtu duhet të kenë vjetërsi në punë dhe ndikim për ti bërë vendimet sa më autoritare në lidhje me shkëmbimin e të dhënave.

Rishqyrtimi i marrëveshjeve për shkëmbimin e të dhënave

Marrëveshjen për shkëmbimin e të dhënave ju duhet ta shqyrtoni rregullisht. Kjo për shkak se mund të ndodhin ndryshime dhe ato duhet të pasqyrohen në marrëveshjen tuaj për t'u siguruar që shkëmbimi ende mund të justifikohet. Në qoftë se jo, atëherë ajo duhet të përfundojë. Gjatë shqyrtimit të marrëveshjes ju duhet të pyesni vetën rregullisht nëse:

- *A duhen ende të mbahen, përpunohen dhe shkëmbehen të dhënat?* Ju mund të zbuloni se qëllimi i shkëmbimit të të dhënave është arritur dhe se nuk është i nevojshëm shkëmbimi i mëtejshëm. Nga ana tjetër, ju mund të zbuloni se shkëmbimi i të dhënave nuk ka dhënë asnjë ndikim në qëllimin tuaj dhe për këtë arsye shkëmbimi nuk është më i justifikuar.

- *A e keni të pasqyruar procesin e shkëmbimit (përhapjes) dhe lidhjen e marrëveshjes së shkëmbimit të të dhënave në formularin e njoftimit të plotësuar pranë Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale?* Për informacione të mëtejshme mbi procedurën e njoftimit lutemi konsultohuni me Kreun VI të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale.

- *A janë akoma të përshtatshme procedurat e mbledhjes së informacionit tuaj dhe a funksionojnë ato në praktikë?* Të gjitha institucionet e përfshira në shkëmbim duhet të kontrollojnë:

- nëse është e nevojshme për të shkëmbyer të gjitha të dhënat personale, apo nëse mund të përdoret ndonjë informacion anonim;

- se të dhënat e shkëmbyera janë ende të cilësisë së duhur;

- a janë ende duke u zbatuar si duhet periudhat e ruajtjes së të dhënave nga të gjithë institucionet e përfshira në shkëmbim;

- që të gjitha institucionet e përfshira në shkëmbim kanë arritur dhe ruajtur një nivel të duhur të sigurisë;

dhe

- që personeli është trajnuar siç duhet dhe që ata janë të vetëdijshëm për përgjegjësitë në lidhje me të dhënat e shkëmbyera ku ata kanë akses.

- *A keni kontrolluar nëse i keni krijuar mundësinë për akses subjekteve të të dhënave në të dhënat e shkëmbyera?*

- *A keni kontrolluar nëse i jeni përgjigjur kërkesave dhe ankesave të subjekteve, në mënyrën e duhur dhe nëse janë bërë përmirësime në marrëveshjen e shkëmbit të të dhënave?*

Nëse do të bëhen ndryshime të rëndësishme në marrëveshjet për shkëmbimin e të dhënave, atëherë këto ndryshime duhet të bëhen publike në mënyrë të përshtatshme. Kjo mund të bëhet duke përditësuar faqet e internetit ose duke dërguar drejtpërsëdrejti mesazhe elektronike subjekteve.

Siguria

Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale kërkon që kontrolluesit të kenë marrë masa të duhura teknike dhe organizative, kur kryhet përpunimi i të dhënave personale. Kontrolluesit mund të jenë të njohur me informacione mbi mbrojtjen e të dhënave që ata mbajnë, por krijimi i bazës së sigurisë në lidhje me informacionin e përbashkët mund të paraqesë sfida të reja.

Është praktikë e mirë për të marrë masat e mëposhtme në lidhje me informacionet ose të dhënat që ju ndani me kontrollues të tjerë, ose që kontrollues të tjerë ndajnë me ju:

- Rishikoni çfarë të dhënash personale autoriteti juaj merr nga autoritetet e tjera duke u siguruar që ju e dini prejardhjen e tyre dhe nëse ndonjë kusht i është bashkangjitur përdorimit të tyre.
- Rishikoni çfarë të dhënash personale autoriteti juaj shkëmben me autoritetet e tjera duke u siguruar që ju e dini se kush ka akses në to dhe se për çfarë do të përdoren.
- Vlerësoni nëse ju shkëmbeni ndonjë të dhënë që është sensitive. Sigurohuni që ju ti mundësoni këtyre të dhënave një nivel të lartë të sigurisë.
- Identifikoni se cili ka akses në informatat që autoritetet e tjera kanë ndarë me ju. Ju duhet të shmangni dhënien e aksesit për të gjithë stafin për shkëmbimin e informacionit në qoftë se vetëm pak prej tyre kanë nevojë për të, për të kryer punën e tyre.
- Konsideroni efektin që mund të sjellë shkelja e sigurisë për subjektin e të dhënave personale.
- Konsideroni efektin që mund të sjellë një shkelje e sigurisë në autoritetin tuaj në aspektin e reputacionit apo mungesës së besimit nga konsumatorët apo klientët tuaj. Kjo mund të jetë veçanërisht e mprehtë kur një subjekt i jep të dhënat e tij një kontrolluesi dhe kontrolluesi marrës i jep tek persona të tretë.

Ju duhet të synoni për të ndërtuar një kulturë brenda autoritetit tuaj, ku punonjësit të dinë dhe të kuptojnë praktikën e mirë, në lidhje me të dhënat personale që ata disponojnë dhe ato të marra nga një autoritet tjetër. Personeli duhet të jetë i vetëdijshëm për politikën e sigurisë e të procedurave dhe të trajnohet në aplikimin e tyre.

Në veçanti ju do të duhet të:

- projektioni dhe të organizoni sigurinë tuaj të përshtatshme për llojin e të dhënave personale që publikoni ose merrni dhe dëmin që mund të rezultojë nga një shkelje e sigurisë;

- ju duhet të njihni punonjësit e autoritetit të përfshirë në shkëmbim e të dhënave, të cilët duhet të jenë përgjegjës për të siguruar sigurinë e informacionit. Ata duhet të takohen rregullisht për të garantuar se siguria e duhur është ruajtur;

- keni procedurat e duhura për monitorimin dhe auditimin në vend;

dhe

- jeni të gatshëm për t'iu përgjigjur çdo mosrespektimi në marrëveshjen për shkëmbimin e të dhënave me shpejtësi dhe në mënyrë efektive.

Për të vendosur masat e sigurisë ju duhet ti përcaktoni ato ndërmjet pyetjeve të mëposhtme:

Siguria fizike

- A keni cilësi të mirë të aksesit të sistemeve të kontrollit për ambjentet tuaja?
- Si mbikëqyren vizitorët?
- Informacioni i bazuar në letër (i shtypur) ruhet dhe transferohet në mënyrë të sigurt?
- A qëndrojnë laptopët dhe mediat e lëvizshme (të tilla si disqe dhe USB), të mbyllura gjatë natës?
- A hidhni letrat e konsumuara në mënyrë të sigurt, për shembull duke i grirë?
- A këshilloni në mënyrë të sigurt personelin se si të përdorë telefonat e tyre për të minimizuar rrezikun?

Siguria teknike

- A është siguria juaj teknike e përshtatshme për llojin e sistemit që ju keni, llojin e informacionit që ju mbani dhe atë që ju bëni me të?
- Nëse keni staf që punojnë nga shtëpia, keni marrë masat e sigurisë në vend për të siguruar që kjo të mos komprometojë sigurinë?
- Si është inkriptimi i të dhënave personale i zbatuar dhe i menaxhuar?
- A keni identifikuar rreziqet e zakonshme të sigurisë që lidhen me përdorimin e një web-produkt për shembull, një faqe interneti, aplikimi web ose aplikim celular?
- Si mund të kontrollojnë aksesin në sistemet tuaja?
- Cilat masa përdoren në vendin tuaj të punës për sigurinë e informacionit në transit?

Kur të dhënat personale shkëmbehen, është mirë për kontrolluesin dhënës të informacionit të sigurojë masat adekuate për kontrolluesin marrës si dhe aksesin që do të ketë. Kontrolluesi që publikon informacion duhet të sigurohet që kontrolluesi marrës kupton natyrën dhe ndjeshmërinë e informacionit. Duhet ndërmarrë hapa të arsyeshme për të siguruar që këto masa të sigurisë të jenë vendosur, veçanërisht duke siguruar që një sistem të akordojë sigurinë e standarteve dhe është nënshkruar nga të gjitha palët e përfshira në një marrëveshje për shkëmbimin e të dhënave. Ju lutem vini re! Edhe pse kontrolluesit marrin të dhënat, duhet të marrin përgjegjësitë e tyre ligjore në lidhje me përpunimin e të dhënave, duke përfshirë edhe sigurinë e tyre.

Vështirësitë mund të lindin kur kontrolluesit të përfshirë kanë standarde të ndryshme të sigurisë dhe përdorin sisteme të ndryshme mbrojtëse. Gjithashtu mund të jetë e vështirë për të vendosur standarde të përbashkëta të sigurisë, ku ka ndryshime në kontrollues me sistemet IT dhe procedurat. Këto probleme duhet të zgjidhen para se të dhënat personale të jetë shkëmbyer.

Marrëveshjet për shkëmbimin e të dhënave

Marrëveshjet për shkëmbimin e të dhënave mund të marrin forma të ndryshme, në varësi të shkallës dhe kompleksitetit të shkëmbimit të të dhënave në fjalë. Ju duhet të mos harroni se një marrëveshje për shkëmbimin e të dhënave është një grup i rregullave të përbashkëta të detyrueshme për të gjitha institucionet e përfshira në një nismë të shkëmbimit të të dhënave. Kjo do të thotë se marrëveshja duhet të hartohet në një gjuhë të qartë, koncize dhe që kuptohet lehtë.

Marrëveshja duhet t'ju ndihmojë për të justifikuar shkëmbimin e të dhënave tuaja dhe për të treguar se ju keni qenë i ndërgjegjshëm, dhe keni dokumentuar, çështjet përkatëse të pajtueshmërisë.

Në mënyrë që një marrëveshje të jetë e vlefshme duhet të përmbajë disa klauzola, të tilla si:

Qëllimin e iniciativës për shkëmbimin e të dhënave:

Marrëveshja juaj duhet të shpjegojë pse iniciativa për shkëmbimin e të dhënave është e nevojshme, qëllimin specifik që keni dhe përfitimet që ju shpresoni t'u sillni subjekteve ose shoqërisë më gjerësisht. Kjo duhet të jetë e dokumentuar në terma të sakta në mënyrë që të gjitha palët të jenë absolutisht të qartë për qëllimet për të cilat të dhënat mund të shkëmbehen dhe të dhënat e shkëmbyera të mund të përdoren.

Institucionet që do të jenë të përfshira në shkëmbimin e të dhënave:

Marrëveshja juaj duhet të identifikojë qartë të gjitha institucionet që do të përfshihen në shkëmbimin e të dhënave dhe duhet të përfshijë detajet e kontaktit për anëtarët kyç të stafit të tyre. Ajo gjithashtu duhet të përmbajë procedura për përfshirjen e institucioneve shtesë në marrëveshjen për shkëmbimin e të dhënave dhe të trajtojë rastet kur një institucion duhet të përjashtohet nga shkëmbimi.

Kategorizimin e të dhënave për t'u shkëmbyer:

Marrëveshja juaj duhet të shpjegojë llojet e të dhënave që ju synoni të shkëmbeni me institucionet e përcaktuara më lart. Kjo mund të jetë e nevojshme dhe të jetë mjaft e detajuar, sepse në disa raste do të jetë e përshtatshme për të shkëmbyer detaje të caktuara në një dosje për dikë, ndër të tjera mund të jenë të dhëna sensitive.

Baza për shkëmbimin:

Ju duhet të shpjegoni në mënyrë të qartë bazën tuaj ligjore për shkëmbimin e të dhënave. Nëse ju jeni pjesë e sektorit publik, ju mund të keni detyrimin ligjor për të shkëmbyer lloje të caktuara të të dhënave personale. Ju duhet të shpjegoni bazën ligjore e cila ju lejon ju të kryeni shkëmbimin.

Në rastet kur marrja e pëlqimit është kusht detyrues për shkëmbimin e të dhënave atëherë marrëveshja juaj duhet të shoqërohet me formularin për deklarimin e pëlqimit. Formulari duhet të përmbajë klauzole rreth refuzimit apo revokimit të pëlqimit.

E drejta e subjektit për akses:

Në marrëveshje duhet të parashikohet procedura që duhet të ndjekë subjekti i të dhënave në rast se paraqet pranë institucionit kërkesë për akses në të dhënat e tij të cilat janë shkëmbyer. Duhet që çdo anëtar i stafit ti sigurojë subjektit pa pagesë informacionin e kërkuar. Edhe pse vendimet për akses shpesh do të duhet të merren rast pas rasti, marrëveshja juaj duhet të japë një përmbledhje të gjerë të llojeve të të dhënave që ju normalisht do ti përgjigjeni në bazë të kërkesës së paraqitur.

Aksesi në informacion:

Marrëveshja juaj gjithashtu duhet të merret me problemet kryesore që mund të lindin gjatë shkëmbimit të të dhënave personale. Të gjitha institucionet e përfshira në shkëmbim duhet:

- të kenë këshilla të hollësishme se cili grup të dhënash mund të shkëmbehet, për të parandaluar që të bëhet i ditur informacion i tepruar apo i pavend;
- të sigurojnë që të dhënat e shkëmbyera janë të sakta, për shembull duke kërkuar një ushtrim periodik të mostrave;
- të sigurojnë që grupe të dhënash të ndryshme duhet të regjistrohen në të njëjtën mënyrë. Në marrëveshje mund të përfshihen shembuj që tregojnë se si duhet të regjistrohen njësi të dhënash të veçanta - për shembull datat e lindjes;
- të kenë rregulla të njëjta për ruajtjen dhe asgjësimin e njësive të të dhënave të shkëmbyera dhe procedura për trajtimin e rasteve të ndryshme, ku institucione të ndryshme mund të kenë rregulla të ndryshme të përcaktuara me ligj mbi ruajtjen dhe asgjësimin;
- të ketë marrëveshje të përbashkëta teknike dhe organizative të sigurisë, duke përfshirë transmetimin e të dhënave dhe procedurat që duhet të ndiqen kur kemi të bëjmë me shkeljen e marrëveshjes;

- të ketë një plan kohor për vlerësimin e efijencës së vazhdueshme për shkëmbimin e të dhënave dhe marrëveshjes që e rregullon atë; dhe
- të ketë procedura që trajtojnë përfundimin e iniciativës për shkëmbimin e të dhënave, duke përfshirë asgjësimin e të dhënave të përbashkëta apo kthimit në institucionin që i ka pasur ato fillimisht.

Mund të jetë e dobishme për marrëveshjen tuaj të ketë një shtojcë, ku të ketë të përfshirë:

- përkufizimin e termave;
- një përmbledhje të dispozitave legjislative;
- një formular për të kërkuar pëlqimin e subjekteve për shkëmbimin e të dhënave; dhe
- një diagramë për të treguar procedurë që do të ndiqet nëse do të shkëmbejnë të dhëna.

Ju gjithashtu mund të përdorni si shtojcë në marrëveshje edhe:

- një formular kërkesë për shkëmbimin e të dhënave; dhe
- një formular vendimi për shkëmbimin e të dhënave.

Aneksi 1- Përkufizime

Me qëllim kuptimin sa më të qartë të termave që ju mund të përdorni gjatë procesit të shkëmbimit të të dhënave, më poshtë janë pasqyruar disa përkufizime që do të ju ndihmojnë në kuptimin e qartë të kodit praktik.

- ✓ “Autoritet publik” kuptohet çdo organ i administratës shtetërore dhe i enteve publike;
- ✓ “Dokument zyrtar” kuptohet dokumenti i çdo lloji, i mbajtur nga autoriteti publik, në përputhje me rregullat në fuqi dhe që ka lidhje me ushtrimin e një funksioni publik;
- ✓ “Të dhëna personale” është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.
- ✓ “E dhënë anonime” është çdo e dhënë, që në origjinë ose gjatë përpunimit, nuk mund t’i shoqërohet një individ, të identifikuar ose të identifikueshëm.
- ✓ “Të dhëna sensitive” është çdo informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij, racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin, fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale.
- ✓ “Kontrollues” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.
- ✓ “Subjekt i të dhënave personale” është çdo person fizik, të cilit i përpunohen të dhënat personale.
- ✓ “Përpunues” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që përpunon të dhëna personale në emër të kontrolluesit.
- ✓ “Sistem arkivimi” është çdo grup i strukturuar i të dhënave personale, të cilat janë të aksesueshme në bazë të kriterëve specifike, të centralizuara, të decentralizuara ose të shpërndara në një bazë, funksionale ose gjeografike.
- ✓ “Tregtim i drejtpërdrejtë” është komunikimi me çdo mjet dhe mënyrë i materialit reklamues, duke përdorur të dhënat personale të personave fizikë ose juridikë, të agjencive ose njërive të tjera, me ose pa ndërmjetësim.

- ✓ “Përpunim i të dhënave personale” është çdo veprim ose grup veprimesh, të cilat janë kryer mbi të dhënat personale, me mjete automatike ose jo, të tilla si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, shfrytëzimi, transmetimi, shpërndarja ose ndryshe duke vënë në dispozicion, shtrirja ose kombinimi, fotografimi, pasqyrimi, hedhja, plotësimi, seleksionimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi, edhe në qoftë se nuk janë të regjistruara në një bankë të dhënash.
- ✓ “Marrës” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër të cilit i janë dhënë të dhënat e një palë të tretë ose jo. Autoritetet, të cilat mund të marrin të dhëna në kuadrin e një hetimi të veçantë, nuk konsiderohen si marrës.
- ✓ “I ngarkuar” është personi që kryen përpunimin e të dhënave, me autorizim nga titullari ose personi përgjegjës.
- ✓ “Palë e tretë” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër, përveç subjektit të të dhënave, kontrolluesit, përpunuesit dhe personave, të cilët, nën autoritetin e drejtpërdrejtë të kontrolluesit apo përpunuesit, janë të autorizuar të përpunojnë të dhëna.
- ✓ “Transmetim” është transferimi i të dhënave personale te marrësit.
- ✓ “Përhapje” është komunikimi i informacionit për të dhënat personale palëve të papërcaktuara, në çfarëdo forme, edhe përmes vënies në dispozicion ose konsultimit.

Aneks 2 - Model i formës së kërkesës për shkëmbimin e të dhënave

Emri i kontrolluesit:	
Emri dhe pozicioni i personit që kërkon të shkëmbejë të dhëna: (personi i ngarkuar nga kontrolluesi)	
Data e kërkesës:	
Referenca në marrëveshjen për shkëmbimin e të dhënave:	
Qëllimi i shkëmbimit:	
Ndonjë marrëveshje specifike mbi mbajtjen/fshirjen e të dhënave:	
Nënshkrimi:	
Data:	

Aneks 3 - Model i formës së vendimit për shkëmbimin e të dhënave

Emri i kontrolluesit:	
Emri dhe pozicioni i personit që kërkon të shkëmbejë të dhëna: (personi i ngarkuar nga kontrolluesi)	
Data e marrjes së kërkesës:	
Të dhënat e kërkuara:	
Qëllimi:	
Vendimi:	
Arsyet për përhapje apo mos përhapje të të dhënave:	
Vendimi është marrë nga: (emri dhe pozicioni)	
Nënshkrimi:	
Data:	